



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Nr 481 Prot

Vlorë më 03/04/2024

VENDIM

Nr. 3 datë 26/03/2024

“PËR MIRATIMIN E TAVANEVE PËRGATITORE TË TË ARDHURAVE TË
PROGRAMIT BUXHETOR AFAT – MESËM “2025 -2027”

Këshilli i Qarkut Vlorë pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga *Grupi i Menaxhimit Strategjik*, për hartimin e tavanëve përfundimtare për PBA 2025-2027, mbështetur në:

- Ekonomisë nr 03, dt. 28.02.2024 “Për përgatitjen e programit buxhetor vendor afat - mesëm 2025-2027 Ligjin nr.139 datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 41, pika 1, neni 83, pika ç.
- Ligjin nr.68 dt.2017 “Për financat e vetqeverisjes vendore” neni 52, pika 2.
- Ligji nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar.
Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.23 datë 30/07/2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së Programit buxhetor Afat – Mesëm të njëjësive të Vetqeverisjes Vendore”.
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.03, datë 28.02.2024, “Për përgatitjen e programit buxhetor vendor afat-mesëm 2025-2027.

V E N D O S I:

- 1.Të miratojë tavanet Përgatitore për përgatitjen e Programit buxhetor afatmesëm 2025-2027:
-Planin e transfertës së pakushtëzuar
-Planin e transfertës së kushtëzuar
-Planin e të ardhurave të Këshillit të Qarkut sipas lidhjes “Tavanet përgatitore të të ardhurave” që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij .
- 2.Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Grupi i Menaxhimit Strategjik, Zyra Financë – Buxhet - Shërbime.
- 3.Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit në Këshill.

KRYETAR

ERVIS MOCKA

Shpallur nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresë Nr. 311 Prot., datë 08.04 2024

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës “Labëria” Vlorë
Vlorë (AL), 9401

Website: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600

Tavanet Përgatitore të PBA 2025-2027

Transferta e pakushtëzuar

Këshilli i Qarkut

në lekë

2025	2026	2027
59,810,000	62,206,000	64,602,000

Transferta e Kushtëzuar

Funksion i deleguar - DAMT

në lekë

2025	2026	2027
10,256,914	10,300,000	10,400,000

Transferta e Kushtëzuar

Shërbimet e Qëndrë Sociale Vatra

në lekë

2025	2026	2027
18,500,000	18,900,000	20,500,000

Të ardhura të planifikuara

Këshilli i Qarkut

në lekë

2025	2026	2027
14,850,000	16,400,000	16,500,000

TOTALI

në lekë

2024	2025	2026
103,416,914	107,806,000	112,002,000



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË**

RAPORT

**PËR HARTIMIN E TAVANEVE PËRGATITORE PËR PROGRAM BUXHETIN
AFATMESËM 2025 - 2027**

- Grupi i Menaxhimit Strategjik, i kryesuar nga Kryetari i Këshillit të Qarkut ju paraqet raportin mbi vlerësimet dhe parashikimet afatmeseme përgatitore të të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhat 2025 – 2027 sipas strukturës.
- Përgatitja e tavaneve përgatitore të të ardhurave të programit buxhetor afatmesëm 2025 – 2027 , mbështetur : në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, në ligjin nr. 68/2017 “Për Financat e vetëqeverisjes Vendore”, udhëzimin e Ministrisë së Financave nr 23, datë 30.07.2018 “ Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore” ; udhëzimin e Ministrisë së Financave nr 3 datë 28.02.2024 “ Për përgatitjen e programit buxhetor Afatmesëm Vendor 2025 – 2027” .

I. Organizimi i punës për hartimin e PBA-së 2025 - 2027

1. Ngritja e grupit të punës

Me urdhër nr 08 datë 05.01.2024 , “Për miratimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik” nën drejtimin e Kryetarit të Këshillit të Qarkut u ngrit Grupi i Menaxhimit Strategjik për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe përgatitjen e projekt buxhetit afatmesëm, sipas programeve të Këshillit të Qarkut. Grupi i Menaxhimit Strategjik do të mbështetet në kalendarin e programit buxhetor afatmesëm, 2025-2027, miratuar me Vendimin e Këshillit të Qarkut nr. 18 datë 29.12.2023 , për të vepruar sipas strukturave përkatëse me qëllim realizimin e çdo detyre sipas afateve të përcaktuara në vendim.

2. Ndarja e kuotave sipas programeve

Nën drejtimin e Kryetarit të GMS në datë 23.02.2024 u organizua takimi i grupit për planifikimin e buxhetit për vitet 2025 - 2027, duke marrë në analizë realizimin e buxhetit në vitet 2023 dhe 2022, zbatimin për vitin 2024 dhe planifikimin për vitet 2025-2027. Në takim u diskutuan vlerat



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

për transfertën e pakushtëzuar, transfertat e kushtëzuara dhe të ardhurat e realizuara sipas viteve të shprehura në tabelën e mëposhtme.

Programi	Emertimi i të Ardhurave	Fakti 2022	Fakti 2023	Plani për vitin 2024
01110	Të ardhurat e veta	13,355	16,223	17,300
01110	Transferta e pakushtëzuar Trashëguar (grant)	27,390	51,665	44,116
01110	Të ardhurave te trashëguara (të ardhura)	27,995	40,352	32,214
01110	Transferta e pakushtëzuar	43,933	53,515	58,339
01160	Transferta të kushtëzuara DAMT	6,603	8,723	9,573
10430	Transferta të kushtëzuara Shërbimi Social	9,499	9,499	17,426
01160	Te ardhura kap 6	218	218	218
	Të ardhurat gjithsej	132,487	183,690	179,189

- Nën drejtimin e Kryetarit të GMS në datë 27 Shkurt 2024 u organizua takimi i grupit për parashikimin e të ardhurave të përgatitjes së kërkesave të programit buxhetor vendor afat – mesëm 2025 – 2027.

Në takim u diskutuan parashikime të treguesve ekonomik dhe financiar, të buxhetit të njësisë së qeverisjes vendore për tre vitet e ardhshme, duke ofruar vlerësime të burimeve që qarku do të ketë në dispozicion, për të financuar shpenzimet e tij. Grupi diskutoi rreth buxhetit, burimeve financiare për tre vitet e ardhshme, të përbëra nga transfertat e pakushtëzuara, sipas udhëzimit nr 3 datë 28.02.2024, transfertat e kushtëzuara dhe të ardhurat që do parashikohen sipas viteve 2025–2027, të ardhurat e vet institucionit nga shërbimet që ofron dhe të ardhurat nga kuota e anëtarësisë. Pjesë e diskutimit ishin dhe projekt idetë për aktivitetet që do të planifikohen në vitet në vazhdim me synim arritjen e objektivave të Këshillit të Qarkut.

3.5.2 treguesit financiarë 2025 – 2027

Informacion financiar

3.1 Supozimet e planifikimit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI I QARKUT VLORË

Në lidhje me llogaritjet makroekonomike nuk kemi përcaktuar tarifa me efekte negative, pra nuk u kemi caktuar vlera në asnjë element të faktorëve makroekonomik që mund të kenë impakt në vlerësimin e burimeve, pasi burimet e financimit të qarkut janë vetëm kuotat e anëtarësisë së bashkive (të cilat vendosen me vendim tëkëshillave përkatës) dhe tarifatat të cilat vendosen me vendim të Këshillit të Qarkut. Në këtë kontekst nuk shohim asnjë prej elementëve makro si përcaktues të këtij vlerësimi.

3.2 Burimi i të ardhurave

Ky program Buxhetor, pasqyron parashikime të treguesve ekonomik dhe financiar, të buxhetit të njësisë së qeverisjes vendore për tre vitet e ardhshme, duke ofruar vlerësime të burimeve që qarku do të ketë në dispozicion, për të financuar shpenzimet e tij. Grupi diskutoi rreth buxhetit, burimeve financiare për tre vitet e ardhshme, të përbërë nga transfertat e pakushtëzuar, të ardhurat e vet institucionit nga shërbimet që ofron dhe të ardhurat nga kuota e anëtarësisë. Pjesë e diskutimit ishin dhe projekt idetë për aktivitetet që do të planifikohen në vitet në vazhdim me synim arritjen e objektivave të Këshillit të Qarkut.

Për Këshillin e Qarkut mbetet prioritet “Zhvillimi dhe zbatimi i politikave rajonale në Qarkun Vlorë, në fushat ekonomike, turizmit, kulturës, shërbimit social, trashëgimis kulturore, mjedisit. Në planifikimin e të ardhurave të veta, për periudhën 2025 – 2027, GMS pati parasysh :

Në bazë të Ligjit nr. 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore “, neni 38 qarku i siguron të ardhurat nga :

- Transfertat e pakushtëzuar dhe planifikimi i këtij zëri është bërë në bazë të vlerës së pakushtëzuar në përputhje me nivelin e financimit të miratuar në kuadrin makroekonomik dhe fiskal për periudhën “ 2025-2027” . Sipas udhëzimit nr 3 dt 28.02.2024 të Ministrisë së Financave.
- Burim tjetër i të ardhurave janë transferat e kushtëzuara për kryerjen e funksioneve dhe kompetencave të deleguara, në rastin konkret për programet Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Qark dhe Qendra Psiko- Sociale Vatra.
- Burim tjetër i krijimit të të ardhurave janë tarifatat për shërbimit publik të ofruara nga institucioni, të ardhurat nga tarifatat shërbimi : DAMT, Urbanistika, si dhe tarifatat e shërbimeve të tjera administrative. Ato janë planifikuar duke marrë në konsideratë trendin e viteve të fundit.
- Gjithashtu Qarku financohet nga kuotat e anëtarësisë së bashkive përbërëse, të përcaktuara në buxhetin vjetor të bashkive. Kuota e anëtarësisë për financimin e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

buxhetit të qarkut përcaktohet me vendim të këshillit bashkiak dhe është planifikuar në bazë të eksperiencës së planifikimit në tre vitet e fundit, realizimin e të ardhurave nga kuota e anëtarësisë nga shtatë bashkitë përbërëse të Qarkut për vitin 2023 dhe të pritshmin e vitit 2024, por theksojmë problematikën e arkëtimit në këtë zë e cila nuk shkon në përputhje me planifikimin.

- Gjithashtu dhe nga të ardhurat e trashëguara të pa përdorura.

Parashikimi i të ardhurave. Për Vitet 2025 – 2027

Program i	Emërtimi i të Ardhurave	Parashikimi për vitin 2025	Parashikimi për vitin 2026	Parashikimi për vitin 2027
01110	Të ardhurat e veta	14,850	16,400	16,500
01110	Transferta e pakushtëzuar	59,810	62,206	64,602
01160	Transferta të kushtëzuara DAMT	10,256	10,300	10,400
10430	Transferta të kushtëzuara Shërbimi Social	18,500	18,900	20,500
	Të ardhurat gjithsej	206,833	215,806	224,004



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË**

Për Këshillin e Qarkut mbetet prioritet “ Zhvillimi dhe zbatimi i politikave rajonale në Qarkun Vlorë, në fushat ekonomike, turizmit, kulturës, shërbimit social, trashëgimisë kulturore, mjedisit etj, harmonizimi i tyre me politikat shtetërore në bashkëpunim me të shtatë bashkitë e Qarkut dhe ushtrimi i funksioneve të deleguara ,,

Mbi bazën e këtyre vlerësimeve institucioni do të përcaktoje tavanet e shpenzimeve të PBA-së, 2025 – 2027.

Sfidat dhe risqet kryesore në realizimin e objektivave janë:

- Miratimi i fondit për shërbimin e qendrave të kujdesit social nga Ministria përkatëse, i cili ka ardhur gjithmonë me vonesë.
- Bashkëpunimi me bashkitë për realizimin e të ardhurave nga kuota e antarësisë, detyrimet e prapambetura, marrjen e angazhimeve të përbashkëta në projekte të ndryshme

KRYETAR

ERVIS MOCKA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË